



Viti i XV-të I Botimit, Nr.1,

Qershor 2023

UNIVERSITETI, ZHVILLIMI DHE INOVACIONI. SFIDAT E UNIVERSITETIT NË ERËN TONË

Erda Qorri*, Vera Ostreni, Anesti Kondili**

“University, Development, and Innovation. The challenges of the university in our era”

*Fakulteti Shkencave Mjekësore “Albanian University”

**Universiteti Mjekësisë Tiranë.

Arsimi i Lartë në Shqipëri, sikurse të gjitha vendet e Europës e më gjerë janë duke u përballur me zhvillime të reja në një epokë të re. Është koha e informacionit dhe dijes, dhe kjo për shkak të mbështetjes në kërkimin shkencor, kreativitetin dhe inovacionin. Edukimi dhe teknologjia arsimore ka përjetuar një përsheptim dramatik gjatë tre viteve të fundit, gjatë dhe pas krizës së pandemisë Covid-19. Fuqia punëtore e së ardhmes varet nga përshtatja e universiteteve të sotëm ndaj ndryshimeve të shekullit të 21-të. Aftësi të tilla përfshijnë të menduarit kritik, komunikimin, bashkëpunimin dhe një mentalitet të rritjes. Universiteti i së ardhmes është i vendosur të ofrojë një përvojë mësimore më të personalizuar. Ai do të kapërcejë hendekun midis arsimit dhe tregut gjithnjë e më konkurrues përmes praktikave të mira dhe universiteteve në partneritet me bizneset. Universitetet do të ofrojnë një mjedis arsimor të paracaktuar për t'u kujdesur për një gamë më të gjerë studentësh përtej kufijve. Modeli vetëm në kampus do të bëhet i vjetëruar gjatë kësaj dekade.¹ Universitetet do duhet ti përshtaten ndryshimeve. Ekonomia globale gjithnjë e më e hapur paraqet sfida për vendet dhe rajonet anembanë botës se si duhet të përgjigjen për të maksimizuar përfitimin ekonomik brenda këtij kuadri që ndryshon me shpejtësi. Ndryshimi është ai i tranzicionit nga ekonomitë e bazuara në treg pune dhe kapital, në ato të bazuara në informacion dhe njohuri.² Gjithashtu, themelet e sotme janë hedhur mbi arritjet e revolucionit industrial të ndjekur nga revolucioni i informacionit dhe komunikimit. Për më tepër, hapja globale dhe zhvillimi thelbësor në mjetet e lëvizshmërisë dhe komunikimit tregoi se risitë, arritjet dhe shpikjet e arritura nuk janë fundi, por ende duhet të transformohen dhe përkthehen në fushën praktike industriale, duke arritur fitime rekord. Kjo shkaktoi shndërrimin në ekonomi të dijes si rezultat i natyrshëm i transformimit efektiv në shoqëritë e shumë vendeve.³ Universitetet evropiane janë shumë të pafinancuara për detyrat që u kërkohet të ndërmarrin.^{4,5} Megjithatë rrethanat ndryshojnë midis vendeve dhe institucioneve dhe ekzistojnë disa përjashtime të dallueshme, pasoja e përgjithshme është se performanca e universiteteve evropiane është në rënie në krahasim me konkurrentët e saj, më pak se 25% e popullsisë së punës ka pasur arsim të lartë krahasuar me 38% në SHBA dhe 36% në Japoni.⁶ Përpos këtij realiteti, Universitetet u përballën me situta të jashtëzakonshme si ajo e pandemisë Covid-19. Të gjendur përballë mbylljes globale univeristetet shqiptare dhe jo vetëm u desh të përshtaten shumë shpejt me platformat dixhitale për ecurinë e procesit akademik. Integrimi i teknologjive dixhitale për të përshpejtuar transformimin dixhital nuk është më diçka e këndshme apo ekskluzive për institucionet e pasura. Është një domosdoshmëri në vitin 2023 dhe më tej për të optimizuar mjediset hibride të të mësuarit ndërsa ata i bashkohen universitetit të së ardhmes. Arsimi i lartë po ecën përpara drejt një modeli tribrid i cili rrjedh midis mjediseve të mësimdhënies në prezencë, online dhe të simuluar. Global Market Insights parashikon që tregu i e-Learning do të kalojë 1 trilion dollarë deri në vitin 2028. Sektori i teknologjisë së arsimit të lartë është vendosur të sjellë avancim të mëtejshëm në kolegje dhe universitete gjatë gjithë vitit 2023, duke riformuar dhe ngritur sistemin arsimor të shekullit të

21-të me ndihmën e AI (Inteligjencës Artificiale), VR, AR (Virtual and Augmented Reality) Digital Twins dhe Metaverse. Deri në vitin 2025, shpenzimet globale dixhitale për arsimin janë parashikuar të jenë mbi 350 miliardë dollarë.⁷ Nxënësi i sotëm dëshiron të marrë jo vetëm mësimdhënie të shkëlqyer, por edhe aftësitë që i nevojiten për të hyrë në tregun e punës. Në kohën e regjistrimit, studentët mbajnë “pushtetin”. Ata do të kërkojnë kthimin më të mirë të investimit të kohës dhe tarifës së tyre. Studentët janë konsumatorë që duan të plotësohen nevojat e tyre. Për të ecur drejt universitetit të së ardhmes, është thelbësore që udhëheqja e universitetit të kuptojë dhe t’i përgjigjet asaj që studentët aktualë dhe të ardhshëm duan nga përvoja e tyre universitare. Universitetet e sotme përballen me sfida dhe kërcënime të ndryshme.

“Albanian University” si pjesë përbërëse e sistemit të Arsimit të Lartë në Shqipëri, paraqet një strategji vizionare, e cila kontribuon në zhvillimin inovativ të arsimit të lartë në vend. Strategjia ka përcaktuar vizionin, konceptin, orientimet kryesore dhe mekanizmat e modernizimit të arsimit të lartë, bazuar në standardet e procesit të Bolonjës. Strategjia përcakton zhvillimin e arsimit si një nga prioritetet kryesore të zhvillimit social, njerëzor dhe ekonomik të vendit. Strategjia synon të krijojë një sinergji midis standardeve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe tendencave bashkëkohore globale në zhvillimin e arsimit të lartë, duke pasur si pikë kryesore referencë hapësirën universitare europiane.¹⁰ “Albanian University” përfaqëson një nga alternativat serioze, të besueshme, profesionale dhe konkurruese në rrjedhën e zhvillimeve të shumta të Arsimit të Lartë që synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me tregun e punës vendas, rajonal e më gjërë. Institucioni është i orientuar drejt vlerave dhe formave të reja të kërkim-zhvillimit, duke synuar të formojë specialistë të zotë që marrin përsipër e u përgjigjen me dinjitet sfidave të të jetuarit në një shoqëri të hapur. Për hartimin e kësaj Strategjie Albanian University bazohet në Strategjinë Kombëtare për Arsimin e Lartë e cila është në koherencë të plotë me objektivat strategjike të kornizës Edukimi & Trajnimi 2020 për bashkëpunim midis vendeve të Bashkimit Evropian në fushën e arsimit dhe të formimit⁸, me Kuadrin e ri të BE-së për kompetencat kyçe për të nxënëit gjatë gjithë jetës, si dhe me objektivin OZHQ 4 të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Gjithashtu kjo strategji bazohet në Strategjinë Evropiane për Universitetet e cila citon se universitetet e shkëlqyera dhe gjithëpërfshirëse janë kusht dhe themel për shoqëri të hapura, demokratike, të drejta dhe të qëndrueshme, si dhe siguron rritje të qëndrueshme, sipërmarrje dhe punësim.⁹ Qëllimi i saj është të përmirësojë Universitetin, në drejtime të ndryshme, në mënyrë që ky Institucion të radhitet mes Institucioneve cilësore të Arsimit të lartë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe të forcojë bashkëpunimin me IAL të vendeve pjesëmarrëse të procesit të Bolonjës. Strategjia përfshin gjerësisht ndjekjen e orientimeve kryesore me rëndësi për sukses në të ardhmen.

Drejtime strategjike të ndërkombëtarizimit identifikohen dhe shprehen nëpërmjet një sërë objektivash të ndërlidhura. Nisma e Universiteteve Evropiane, Erasmus+, në kombinim me Horizon Europe, Digital Europe dhe instrumente të tjera të BE-së, do të mbështesin aleanca ambicioze ndërkombëtare për të zhvilluar dhe ndarë një bashkëpunim afatgjatë strukturor të qëndrueshëm dhe sistematik në arsim, kërkim dhe inovacion, duke krijuar kampus evropian ndëruniversitar ku studentët, stafi dhe studiuesit nga të gjitha pjesët e Evropës mund të gëzojnë lëvizshmëri të pandërprerë dhe të krijojnë njohuri të reja së bashku. Një diplomë e përbashkët evropiane, që do të jepet në nivel kombëtar, do të vërtetonte rezultatet e të nxënëit të arritura si pjesë e bashkëpunimit ndërkombëtar midis institucioneve partnerë. Një diplomë evropiane duhet të jetë e lehtë për t’u lëshuar, ruajtur, ndarë, verifikuar dhe vërtetuar dhe e njohur në të gjithë BE-në. Në zhvillim të misionit të tij “AU” ka si objektiv të shoqërojë dhe të mbështesë studentët në mënyrë që ai të zhvillojë më së miri potencialitetin e tij. Të nxisë krijimin, transferimin dhe përparimin e dijes për t’ju përgjigjur nevojave për një formimimi të lartë bazuar në kërkimin shkencor në të mirë të shoqërisë. Në realizimin e misionit të tij, universiteti vepron në respekt të të drejtave themelore të njeriut, të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kartat, Deklaratat dhe Konventat evropiane dhe ndërkombëtare. Universiteti promovon zhvillimin e lirë të studimit, procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës, kombëtare dhe ndërkombëtare; hapjen ndaj komunitetit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar; bashkëpunimin me administratën shtetërore; raportin e frytshëm bashkëpunues me ndërmarrjet dhe bizneset, me botën e

punës dhe të profesioneve, me organizatat jo-qeveritare. Universiteti është i pavarur nga çdo lloj orientimi ideologjik, politik apo fetar; vepron në përputhje dhe në respekt të parimeve kushtetuese dhe të dispozitave ligjore në fuqi; garanton lirinë e studimit, të mësimdhënies dhe të kërkimit të lirë shkencor. Universiteti aspirojnë përmbushjen e misionit të tij arsimor në frymën e lirisë dhe të respektit të dinjitetit human, pluralizmit të ideve, transparencës së procedurave, si dhe promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve duke u siguruar mundësi të barabarta për punësim dhe studim në funksion të një qëllimi të përbashkët. Drejtimi kryesor i veprimit afatmesëm është të ndërlidhet oferta arsimore me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e shoqërisë. Në këtë kuptim, studenti, i cili është përfituesi kryesor dhe qendra e veprimtarive të formimit akademik dhe profesional, do të zgjedhë universitetin, sepse do të ketë sigurinë e përvetësimit të aftësive “state of the art” në fushën ku do të zhvillojë veprimtarinë e tij. Strategjia bazohet në tre faza kryesore për implementimin e saj; Zhvillimi i bazave normative për modernizimin e arsimit të lartë, sipas procesit të Bolonjës; Strukturimi i studimeve të larta në tre cikle; Sigurimi i cilësisë së arsimit të lartë; Promovimi i lëvizshmërisë studentore dhe të profesorëve universitarë si dhe ndërtimi i një sistemi arsimor të lartë, i aftë për vetë-organizim dhe vërtetë zhvillim. Garanci për zbatimin me sukses të Strategjisë së Albanian University është kurrikula bashkëkohore, e cila ndërthur më së miri pjesën teorike me atë praktike. Ne kemi zhvilluar një kurrikul të bazuar në kriteret dhe metodologjinë e universiteteve europiane.¹¹ Nëpërmjet kurrikulës moderne universiteti kërkon të plotësojë kërkesën për edukim të individit, të formojë dije dhe identitet kombëtar, të promovojë kulturën kombëtare dhe të promovojë dialogun ndërkulturor. Kurrikula jonë synon të ndërlidhe ndryshime në arsimin e lartë sipas triadës: - traditë – realitet socio-ekonomik e kulturor – vlera europiane. Sepse arsimi është faktor themelor në zhvillimin kombëtar ekonomik, social dhe kulturor. Për ruajtjen e standarteve Albanian University e vë theksin në veçoritë si: cilësia e arsimit, si faktor themelor në cilësinë e jetës, nëpërmjet një cirkuiti cilësi arsimit, cilësi njeriu, cilësi pune, cilësi kulture, cilësi shkence cilësi, jete, cilësi intelekt social; arsimit, faktor bazë në riprodhimin dhe ruajtjen e shëndetit kombëtar; Edukimi në vazhdim (për gjatë gjithë jetës). Universiteti bazohet në cilësi akademike duke u bazuar në 4 amendamente të komisionit Delors;

1. Të mësosh të dish;
2. Të mësosh të bësh;
3. Të mësosh të jetosh në komunitet;
4. Të mësosh të jesh.

Inkurajimi i ndërdisiplinaritetit dhe transdisiplinaritetit në kërkime, duke siguruar bashkëpunimin ndërmjet departamenteve dhe disiplinave për temat e kërkimit dhe duke krijuar kolektive kërkimore që sigurojnë një perspektivë inovative është një nga objektivat e zbatueshmërisë së strategjisë. Mund të angazhohen ndërmjetës me përvojë me formim akademik dhe industrial për të lehtësuar komunikimin ndërmjet palëve bashkëpunuese, veçanërisht në fazat fillestare të një projekti. Universitetet dhe industritë duhet të konsiderojnë fillimin me projekte më të vogla dhe gradualisht të rrisin kompleksitetin e tyre, siç propozohet nga Wit-de-Vries et al.¹¹

Me kalimin e viteve, arsimit i lartë ka tejkaluar krizat dhe ndërprerjet, por këtë herë duket ndryshe. Universitetet duhet të rishpikin veten shpejt ose rrezikojnë të përballen me një brez studentësh që kërkojnë opsione të ndryshme.

Referencat

1. Hugh Lauder & Ken Mayhew (2020) Higher education and the labour market: an introduction, Oxford Review of Education, 46:1, 1-9, DOI: 10.1080/03054985.2019.1699714
2. Schleicher, A. 2006. The economics of knowledge: why education is key for Europe's success. The Lisbon Council, policy brief.
3. Al-Youbi, A.O., Zahed, A.H.M., Nahas, M.N., Hegazy, A.A. (2021). The Roles of Universities in Development. In: The Leading World's Most Innovative Universities. Springer, Cham. https://doi.org/10.1007/978-3-030-59694-1_1
4. Lambert, R. and Butler, N. 2006. The future of European universities: renaissance or decay? Centre for European reform.
5. European Commission. 2006. Delivering on the modernisation agenda for universities: education, research and innovation. COM (2006) 208.
6. European Commission. 2006. Delivering on the modernisation agenda for universities: education, research and innovation. COM (2006) 208.
7. Technology Trends in Higher Education 2023, Susan Fourtané Dec 13, 2022
8. <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026.pdf>
9. <https://education.ec.europa.eu/sites/default/files/2022-01/communication-european-strategy-for-universities-graphic-version.pdf>
10. Erda Qorri et.al. Konferenca I "Universiteti, Zhvillimi dhe Inovacioni" 2016, Forumi i Pavarur i Rektorëve. Proceedings fq.31, ISBN 978-9928-236-03-4. 2017
11. Strategjia Zhvillimit institucional të "Albanian University: 2023-2028. fq 3-7.
12. Wit-de-Vries E, Dolfsma WA, van der Windt HJ, Gerkema MP (2019) Knowledge transfer in university-industry research partnerships: a review. J Technol Transf 44(4):1236–1255. <https://doi.org/10.1007/s10961-018-9660-x>